

VENDIM
Nr. 473, datë 25.7.2012

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM INSPEKTORATIT QENDROR TË NJË PJESE TË GODINËS SË
OBSERVATORIT TË INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË, UJIT E MJEDISIT
DHE DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE
TË NJË PJESE TË GODINËS SË ISH-MINISTRISË SË TRANSPORTEVE E
TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Inspektoratit Qendror të katit zero teknik të godinës së observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dhënie në përdorim Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike të katit zero teknik të godinës së ish-Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lirojnë mjediset përkatëse.
4. Vendimi nr. 655, datë 28.9.2011 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie në përdorim Inspektoratit Qendror të një pjese të godinës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme, Inspektorati Qendror, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha